

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-2935-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	NNT KORABI
NUI	810248791
Adresa	600063903
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	049393266
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Avdullah Morina
Adresa elektronike	nntkorabi@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	29.05.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

-Njoftim per Kontrat – 11.04.2025

-Procesverbali i hapjes se tenderëve – 12.05.2025

-Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – 28.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur këto dispozita të Ligjit për Prokurimin Publik:

- Neni 59: Mos kërkitimi i sqarimeve për dokumentacionin e dorëzuar.
- Neni 6.2 i Udhëzuesit Operativ: Refuzimi i diplomës Bachelor pa specifikim të qartë në DT për kërkesë për Master.
- Neni 60 dhe 66: Mospërfshirja në vlerësim e dokumentacionit të paraqitur për Ing. Infrastruktur rrugore

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

1. **Inxhinieri Blerim** është pjesë e stafit të N.N.T KORABI që nga viti 2012 dhe figuron në mënyrë të rregullt në listën e pagave të kompanisë sonë. Për të janë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në Dosjen e Tenderit, përfshirë:

- **CV-në e plotë,**
- **Referencat për përvojë mbi 5 vjet në projekte të ngjashme,**
- **Kontratën e punës për projektin konkret.**

Bazuar në këto fakte, Autoriteti Kontraktues **nuk ka të drejtë të kërkojë raport nga ATK**, pasi dokumentacioni është **i plotë dhe i mjaftueshëm për të vërtetuar përvojën dhe angazhimin e tij**. Kërkesa për raport nga ATK për periudhën e vitit 2012 është jashtë kërkesave të përcaktuara në DT dhe përbën vendosje të kriterëve shtesë, çka bie ndesh me **nenin 6.2 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim dhe nenin 7.3 të LPP-së** që ndalojnë përjashtimin për arsye që **nuk janë të specifikuara qartë në dosjen e tenderit**.

Më tej, Autoriteti Kontraktues **ka pasur obligim që të kërkojë sqarim**, nëse ka pasur ndonjë paqartësi, sipas **nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik**, dhe jo të përjashtojë ofertën pa një rivlerësim të drejtë dhe të plotë.

2. Për pozitën e kërkuar “Inxhinier i Ndërtimtarisë – Hidroteknik”, në dokumentacionin tonë është paraqitur **Ing. Filloreta Morina**, e cila posedon **diplomë Bachelor në Ndërtimtari**. Në Dosjen e Tenderit **nuk është specifikuar në asnjë vend se kërkohet titulli akademik Master**, prandaj, kërkesa që diploma e saj të refuzohet për shkak të mungesës së titullit Master është **e pabazuar dhe përbën vendosje të kriterëve shtesë**, në kundërshtim me **nenin 6.2 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim dhe nenin 7.3 të Ligjit për Prokurim Publik**, të cilat ndalojnë refuzimin e ofertës për kërkesa që nuk janë të përfshira në DT.

Gjithashtu, në dokumentacionin e dorëzuar, **ne kemi përfshirë edhe një kandidat tjetër për këtë pozitë me diplomë Master**, konkretisht **Ing. Fitore Thaqi**, duke tejkaluar në këtë mënyrë kërkesën minimale që është vendosur në DT.

Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues **nuk ka kërkuar asnjë sqarim shtesë**, edhe pse ka pasur bazë ligjore dhe detyrim ta bëjë këtë sipas **nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik**. Mospërfillja e dokumentacionit të dërguar dhe moskërkimi i sqarimeve përbëjnë shkelje serioze të parimeve të barazisë dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik.

3. Për pozitën e kërkuar “Inxhinier i Diplomuar në Ndërtimtari – drejtimi Infrastrukturë Rrugore”, kemi paraqitur **Znj. Nertila Ndreu**, e cila plotëson në tërësi kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për të janë dorëzuar në mënyrë të rregullt dokumentet e kërkuara, përfshirë:

Diplomën universitare në ndërtimtari

CV-në me përvojë të dokumentuar përtej minimumit të kërkuar,

Kontratën e punës për angazhim konkret në këtë projekt.

Nuk kuptojmë pse Autoriteti Kontraktues **nuk ka shqyrtuar me kujdes dosjen**, pasi dokumentacioni për këtë pozitë ishte **i kompletuar dhe i ngarkuar në sistem** konform të gjitha kërkesave të DT-së. Injorimi i dokumenteve të dorëzuara dhe mungesa e verifikimit të tyre përbëjnë shkelje të **nenit 60 dhe nenit 66 të Ligjit për Prokurimin Publik**, të cilat obligojnë autoritetin të bëjë **vlerësim të plotë dhe të drejtë të ofertës** dhe të marrë vendim të arsyetuar.

Duke u mbështetur në faktet e paraqitura më lart dhe në përputhje me nenin **108/A të Ligjit për Prokurimin Publik**, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë **rishqyrtim të plotë dhe të drejtë të dosjes sonë**, duke marrë në konsideratë dokumentacionin e dorëzuar dhe të **përmirësojë gabimet dhe shkeljet e bëra gjatë vlerësimit**.

Si Operator Ekonomik që i kemi përmbushur **të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit**, presim që Autoriteti Kontraktues të **anulojë vendimin e padrejtë për eliminimin tonë** dhe të **na shpallë fitues**, në përputhje me rregullat dhe parimet ligjore që garantojnë konkurrencë të drejtë dhe trajtim të barabartë në procedurat e prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e sipërpërmendura kanë shkaktuar dëme materiale për Operatorin Ekonomik N.N.T KORABI duke e përjashtuar padrejtësisht nga një kontratë për të

cilën ka dorëzuar dokumentacion të plotë dhe përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në DT.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*